



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 25.4.2023

Nr: 408

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E REZULTATIT TË SHORTIT PËR CAKTIMIN E PARTIVE POLITIKE QË DO TË PROPOZOJNË ANËTARIN E KATËRT TË GRUPEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, 95, pika 2, dhe 96, pikat 1 e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 5, datë 16.3.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për procedurat e hedhjes së shortit për caktimin e partive politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave”, në përfundim të procedurës së hedhjes së shortit

V E N D O S:

1. Miratimin e rezultatit të shortit për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Partia politike e opozitës parlamentare që ka të drejtë të propozojë anëtarin e katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, në tavolinat e numërtuara me numër çift, është Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet.
3. Partia politike e opozitës parlamentare që ka të drejtë të propozojë anëtarin e katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, në tavolinat e numërtuara me numër tek, është Partia e Lirisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 25.4.2023 Nr: 408
Ora: 12:00



“Për miratimin e rezultatit të shortit për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”